  - a) Dosje formulare nr. 1864, në ngarkim të shtetasit A. K., 20 fletë total, vënë në dispozicion 8 fletë;
  - b) Dosje formulare nr. 5, në ngarkim të shtetasit Gj. S., 116 fletë në total, vënë në dispozicion 8 fletë;
  - c) Dosje formulare nr. 4783/A, në ngarkim të shtetasit Th. P., 175 fletë në total, vënë në dispozicion 10 fletë;
  - d) Dosje formulare nr. 5130/A, në ngarkim të shtetasit Baba M. S., 37 fletë në total, vënë në dispozicion 8 fletë;
  - e) Dosje gjyqësore nr. 1513, në ngarkim të shtetasit V. Xh., 121 fletë në total, vënë në dispozicion 8 fletë;
  - f) Dosje formulare nr. 304, në ngarkim të shtetasit M. A., 47 fletë në total, vënë në dispozicion 10 fletë;
  - g) Dosje gjyqësore nr. 4180, në ngarkim të shtetasit I. B., vënë në dispozicion 8 fletë;
2. Dokumenti vihet në dispozicion në formë CD.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare:** Gentiana Sula

**Anëtarë:** Altin Hoxha, Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

### **Vendim nr. 397, datë 17.06.2019 (i shkurtuar)**

Bazuar në nenin 36 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

### **V E N D O S I**

1. Të vërë në dispozicion të shtetasit Ç. H. dokumentet si më poshtë:
  - F4. Dosje nr. 3, Mbi gjendjen e të huajve në Durrës;
  - F4. Dosje nr. 9, Qarkore dërguar seksioneve të Sigurimit të Shtetit në rrethe mbi organizimin e punës në organe, përmirësimin e gjendjes, relacion mbi kuadrot;
  - F4. Dosje nr. 20, Buletinë informativë mbi mungesat, shkurtimet në sektorin ekonomik, hekurudha Durrës-Peqin, kantieri i Maliqit;
  - F4. Dosje nr. 22, Promemorie mbi akt-akuzat e grupeve dhe personave armiq, arrestuar nga organet e Sigurimit shtetit për veprimtari armiqësore;
  - F4. Dosje nr. 29, Relacion mbi gjendjen në Kosovë para dhe mbas revolucionit të Inform Byrosë mbi tradhtinë e Titos;
  - F4. Dosje nr. 33, Korrespondencë me Prokurorinë e Përgjithshme mbi arratisjen në Jugosllavi të N. Dh.;

- F4. Dosje nr. 39, Udhëzim i drejtorisë së Sigurimit dërguar degëve të punëve të brendshme mbi organizimin për zbulimin e bazave të diversantëve. Telegram K. H.;
- F4. Dosje nr. 4, Lista emërore e partizanëve të plagosur e të sëmurë kthyer nga Italia ku ishin dërguar për mjekime;
- F4. Dosje nr. 1, Udhëzim dërguar seksioneve të mbrojtjes së popullit mbi masat që duhen marrë për ardhjen në Shqipëri të misioneve anglo-amerikane;
- F4. Dosje nr. 10, Qarkore udhëzuese dërguar seksioneve të Sigurimit mbi marrjen e masave për çarmatimin dhe dorëzimin e armëve që ka popullata;
- F4. Dosje nr. 11, Udhëzim dërguar seksionit të Sigurimit Shkodër mbi elementet në fshat e diversantët në rrethin e Pukës;
- F4. Dosje nr. 12, Udhëzim seksioneve të Sigurimit mbi hetimin dhe arrestimin e personave jugosllave, lista;
- F4. Dosje nr. 15, Raport mbi aktivitetin armiqësor dhe punën e organeve të Sigurimit për zbulimin e kësaj veprimtarie gjatë viteve 1946-1947, etj;
- F4. Dosje nr. 18, Qarkore e përbashkët e Drejtorisë së Sigurimit dhe prokurorisë përgjithshme mbi marrëdhëniet e korrespondencat e tyre në qarqe e rrethe;
- F4. Dosje nr. 23, Promemoria dhe lutja e V. K. drejtuar shokut Enver Hoxha në 1948 dhe 1951 për fajet dhe gabimet, etj;
- F4. Dosje nr. 24, Relacion rreth situatës aktuale në vendin tonë pas tradhtisë së revizionistëve jugosllavë;
- F4. Dosje nr. 26, Relacione mbi qarkullimin dhe bazat e strehimit të bandave në Krujë, Lezhë, Mirditë, Burrel, Pukë, Tropojë, etj;
- F4. Dosje nr. 27, Qarkore dërguar seksioneve të Sigurimit në rrethe mbi evidencën e bashkëpunëtorëve, listën dhe ndryshimet, etj;
- F4. Dosje nr. 28, Udhëzim dërguar seksionit të Sigurimit Berat mbi organizimin e aparatit ndihmës për zbulimin e veprimtarisë armiqësore;
- F4. Dosje nr. 30, Relacion i përgatitur nga N. K. drejtuar shokut Enver Hoxha mbas Plenumit XI në 1948, etj;
- F4. Dosje nr. 31, Relacion mbi disa gabime në punën operative agjenturale të organeve të Sigurimit, etj;
- F4. Dosje nr. 32, Njoftim mbi provokacionet nga jugosllavët në kufirin tonë gjatë periudhës korrik-dhjetor 1948;
- F4. Dosje nr. 34, Buletinë ekonomike mbi dëmtimet, mungesat në sektorin e industrisë, bujqësisë, ndërtimit, etj;
- F4. Dosje nr. 35, Buletinë të Drejtorisë së Sigurimit mbi komentet dhe parullat e elementit armik rreth situatës në vendin tonë para e pas plenumit VIII dhe tradhtisë së jugosllavëve;
- F4. Dosje nr. 36, Buletinë ekonomike mbi dëmtimet dhe sabotimet në sektorin ekonomik shtetëror në të gjithë republikën;
- F4. Dosje nr. 37, Dosje me dokumente e korrespondencë zyrtare e personale mbi K. H.;
- F4. Dosje nr. 38, Relacion mbi aktivitetin armiqësor të elementit kundërshtar dhe grupet në rrethet e republikës;

- F4. Dosje nr. 40, Udhëzime dërguar seksioneve të Degeve të P. Brendshme të rretheve mbi të metat në punën me agjunkturën dhe mbi ndjekjen e objekteve të përpunimit, etj;
- F4. Dosje nr. 41, Urdhër shkresë radiogramë mbi dislokim forcash për bandat e armatosura;
- F4. Dosje nr. 42, Mbi dënimin e disa b.p tradhtarë nga gjykata speciale;
- F4. Dosje nr. 43, Shënime dërguar Degës P. Br. Korçë mbi të cilën kërkohen të dhëna mbi ushtarët monarko fashistë, të vrarë e të kapur më 2 gusht 1949;
- F4. Dosje nr. 44, Relacion Ministrit P. Brendshme mbi nevojën e përcaktimit të rregullave në punën e organeve të Sigurimit me organet e tjera;
- F4. Dosje nr. 45, Instruksion mbi rregullat e veprimit teknik për veprimet teknike gjatë arrestimit dhe hetuesisë të elementëve armiq;
- F4. Dosje nr. 46, Urdhër mbi rregullin e ekzekutimeve të dënimeve me vdekje që japin Gjykatat Popullore sipas ligjit;
- F4. Dosje nr. 47, Qarkore dërguar gjithë organeve dhe reparteve të M. P. Brendshme mbi disa të meta në zbatimin e urdhrave për diversantët;
- F4. Dosje nr. 48, Organizata Fronti i Rezistencës Shqiptare dhe veprimtaria e grupit special në rolin e saj për asgjësim kriminelesh;
- F4. Dosje nr. 48 Organizata Fronti i Rezistencës Shqiptare dhe veprimtaria e grupit special në rolin e saj për asgjësim kriminelësh;
- F4. Dosje nr. 48.1, Promemorie e miratuar nga ministri i P. Brendshme, dt. 31.3.1950 rreth gjykimit të pesë grupeve spiunësh e diversantësh, etj.
- F4. Dosje nr. 48.2, Relacion datë 25.11.1950 i Ministrisë së P. Brendshme drejtuar shokut Enver Hoxha, me propozime për marrje masash në rrethin e Korçës, etj;
- F4. Dosje nr. 5, Korrespondencë mbi problemet e kriminelëve të luftës me Komisionin e Hetimeve për krimet dhe procesverbale;
- F4. Dosje nr. 50, Urdhër i Zëvendësministrit të Punëve të Brendshme dërguar degëve të punëve të brendshme mbi verifikimin e të kaluarës, etj;
- F4. Dosje nr. 50, Urdhër i Zëvendësministrit të Punëve të Brendshme dërguar degëve të punëve të brendshme mbi verifikimin e të kaluarës, etj;
- F4. Dosje nr. 53, Udhëzim dërguar degëve të P. Brendshme mbi procedurën e Sigurimit për të riadhesuarit;
- F4. Dosje nr. 55, Mbi të dhënat që duhet të grumbullojë agjentura jashtë shtetit në drejtim të zbulimit të ushtrisë, etj;
- F4. Dosje nr. 6, Raport mbi punën e seksionit II të mbrojtjes së popullit, dhjetor 1944-mars 1946. Statistika të të arrestuarve;
- F4. Dosje nr. 7, Raport informativ mbi gjendjen ekonomike në gjithë Shqipërinë, zbatimin e reformës agrare, etj;
- F4. Dosje nr. 8, Raport periodik mbi aktivitetin e rretheve dhe grupeve kundërshtarë të elementit armik dhe puna e organeve të Sigurimit për goditjen e tyre;

- F4. Dosje nr. 17, Qarkore e Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit dërguar drejtorive të p. brendshme në rrethe mbi masat operative për kontrollin e personelit të U.n.r.r.a-s dhe shoqëruesve të tyre;
2. Dokumentet vihen në dispozicion në formë CD.
  3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare:** Gentiana Sula

**Anëtarë:** Altin Hoxha, Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

### **Vendim nr. 388, datë 17.06.2019 (i shkurtuar)**

Bazuar në nenin 36 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

### **V E N D O S I**

1. Të vërë në dispozicion të shtetasit E. V. dokumentet si më poshtë:
  - F4. Dosja nr. 111, Relacion mbi arratisjet dhe tendencën e arratisjeve në Shkodër;
  - F4. Dosja nr. 19, Raporti mbi analizën vjetore, Raporti i punës vjetore për organet e zbulim kufirit dhe plani i punës vjetore të degës së zbulimit të kufirit;
  - F4. Dosja nr. 48, Raporti i punës vjetore të degës, analiza e punës, statistikat e agjenturës dhe përpunimet dhe plani i punës vjetore për degën e zbulimit;
  - F4. Dosje nr. 1, Lista emnore e të arratisurve jashtë shtetit, e përpiluar nga zbulimi i kufirit;
  - F4. Dosje nr. 115.6, Përgjithësim dërguar degëve të punëve të brendshme mbi tendencën e arratisjes jashtë shtetit;
  - F4. Dosje nr. 115.7, Përgjithësim mbi arratisjen në Jugosllavi të familjes të S. R. D. në rrethin e Dibrës dhe udhëzim mbi arratisjen familjarisht të N. K. Sh. të rrethit Shkodër;
  - F4. Dosje nr. 17, Relacion mbi kapjen e thyesit të kufirit M. T.;
  - F4. Dosje nr. 193, Procesverbal mbi ish-të arratisurin N. V. V. e deponimet e tij;
  - F4. Dosje nr. 2, Raport vjetor i punës së Sigurimit të kufirit;
  - F4. Dosje nr. 20, Raporte dhe analiza vjetore mbi punën e organeve të zbulimit të kufirit, mbi planin e punës së degës të zbulimit;
  - F4. Dosje nr. 21, Relacion mbi arratisjen e dy familjeve nga Catistra e Pogonit, Gjirokastër;
  - F4. Dosje nr. 23, Raporti i analizës së zbulimit të kufirit, plani i punës degës zbulimit kufirit. Raporti vjetor;
  - F4. Dosje nr. 275, Raport i ministrit mbi arratisjen në Greqi të 27 personave me motobarkën “De Rada” dhe relacione mbi të arratisurit V. dhe K. M.;

- F4. Dosje nr. 29, Raport vjetor mbi disa dobësi në ruajtjen e kufirit dhe raport vjetor mbi punën e K. Zb. Kufirit;
- F4. Dosje nr. 295, Relacion mbi disa arratisje të ndodhura gjatë muajve gusht-shtator 1971 nga radhët e ushtrisë dhe qyteti i Tiranës;
- F4. Dosje nr. 3, Raport mbi punën vjetore të organeve të degës së zbulimit të kufirit, listë shpërngulje e banorëve të zonës;
- F4. Dosje nr. 332, Udhëzime dërguar organeve të punëve të brendshme mbi arratisjen në Jugosllavi të A. D., etj;
- F4. Dosje nr. 336.32, Informacione dërguar udhëheqjes së Partisë e të shtetit për probleme të ndryshme me karakter shoqëror;
- F4. Dosje nr. 336.39, Informacione dërguar K. Q. të Partisë dhe K. Q. të Rinisë mbi veprimtarinë armiqësore e keqbërëse të zhvilluar në radhët e të rinjve gjatë vitit 1973;
- F4. Dosje nr. 36, Raporti i punës vjetore të zbulimit të kufirit. Statistika mbi agjenturën dhe perpunimet. Plani i degës së zbulimit të kufirit;
- F4. Dosje nr. 4, Raporte vjetore mbi veprimtarinë e armikut në brezin dhe zonën kufitare;
- F4. Dosje nr. 40, Relacion mbi vrasjen e thyesit të kufirit P. P.;
- F4. Dosje nr. 414, Relacion mbi arratisjen në Jugosllavi të një familjeje me 5 persona nga rrethi i Tropojës;
- F4. Dosje nr. 43, Raporte për punën e organeve të zbulimit të kufirit për kolegjiunin e ministrisë dhe vendimi. Analiza e degës dhe plani. Statistikat;
- F4. Dosje nr. 456, Informacion dërguar Komitetit Qendror të PPSH mbi arratisjen e shoferit A. A. P. në Francë;
- F4. Dosje nr. 461, Informacion mbi të arratisurin A. B. si agjent i zbulimit amerikan;
- F4. Dosje nr. 63, Komunikata operative mbi ngjarjet e ndodhura në kufi, në drejtim të provokacioneve, etj;
- F4. Dosje nr. 82, Qarkore mbi arratisjen e 11 personave në qarkun e Korçës;

2. Dokumentet vihen në dispozicion në formë CD.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare:** Gentiana Sula

**Anëtarë:** Altin Hoxha, Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

#### **Vendim nr. 423, datë 25.06.2019 (i shkurtuar)**

Bazuar në nenin 36 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

**V E N D O S I**

1. Të vërë në dispozicion të shtetasit S. S. dokumentet si më poshtë:
  - a) Dega XII, Fashikull mbi ngjarjen në Ambasadën Jugosllave, maj 1981, me numër total fletësh 280 (të digjitalizuara 438 faqe)
  - b) Drejtoria II, Dosar mbi goditjet në Kosovë gjatë dhe pas demonstratave të mars-prill 1981, dy volume, me numër total fletësh 531 (të digjitalizuara 585 faqe)
  - c) Drejtoria II, Dosar mbi demonstratat mars-prill-maj 1981, tre volume, me numër total fletësh 687 (të digjitalizuara 798 faqe).
  
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare:** Gentiana Sula

**Anëtarë:** Altin Hoxha, Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

## VENDIME TË ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM TË AUTORITETIT

### Vendim nr. 302, datë 13.05.2019 (i shkurtuar)

Bazuar në ligjin nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” dhe Rregulloren e Brendshme të institucionit “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

### V E N D O S I

1. Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup.
2. Dërgimin e marrëveshjes për vazhdimin e procedurave Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup.
3. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare:** Gentiana Sula

**Anëtarë:** Altin Hoxha, Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

### Vendim nr. 332, datë 23.05.2019 (i shkurtuar)

Bazuar në ligjin nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” dhe Rregulloren e Brendshme të institucionit “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” dhe në ligjin nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

### V E N D O S I

1. Miratimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Kooperacionit Suedez - SIDA (Ambasada Suedeze) dhe Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH).
2. Dërgimin e marrëveshjes për vazhdimin e procedurave Kooperacionit Suedez (SIDA), pranë Ambasadës Suedeze.
3. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare:** Gentiana Sula

**Anëtarë:** Altin Hoxha, Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj



**Vendim nr. 422, datë 25.06.2019 (i shkurtuar)**

Bazuar në ligjin nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” dhe nenin 8 e 35 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 09.05.2014, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

**V E N D O S I**

1. Miratimin e organizimeve të javës përkujtimore të Tepelenës, 20-30 gusht 2019;
2. Ngritjen e një grupi pune për organizimin e aktiviteteve, në bashkëpunim me institucione homologe, partnere dhe të pushtetit lokal;
3. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij vendimi;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare:** Gentiana Sula

**Anëtarë:** Altin Hoxha, Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

## **BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR**

### **Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 8, datë 03.05.2019**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika “b” dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a, c, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 8, datë 03.05.2019, si më poshtë:

#### **Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

1. Deklasifikohet pjesërisht dosja personale nr. 245, kategoria informator, pseudonimi “Kthesa”, me 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Deklasifikohet plotësisht materiali brenda dosjes, përkatësisht “Procesverbal mbi kallëzimin e krimit të kryer” me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket Drejtorisë së Punëve të Brendshme, Tiranë (Ana e Sigurimit).

#### **KRYETARE E KDZH-së**

**Gentiana Sula**

### **Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 9, datë 06.05.2019**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika “b” dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a, c, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 9, datë 06.05.2019, si më poshtë:

#### **Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

1. Dosje me dy fashikuj, nr. 4865, në ngarkim të F. H., me 176 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) fletë dhe 193 (njëqind e nëntëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.

2. Fashikull nr. 1225, në ngarkim të Xh. D. Dosja ka 377 (treqind e shtatëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
3. Dosje formulare nr. 253, kategoria 2/A, në ngarkim të Atë K. K., me 90 (nëntëdhjetë) fletë dhe fashikull nr.1 me 108 (njëqind e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
4. Fashikull mbi ngjarjen në Ambasadës Jugosllave. Dosja përbëhet nga dy volume me 280 (dyqind e tetëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
5. Dosje formulare nr. 331 dhe dy fashikuj në ngarkim të R. M., me 126 (njëqind e njëzet e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
6. Dosje formulare nr. 379, kategoria 2/A, në ngarkim të I. H. N., me 91 (nëntëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
7. Fashikull nr. 407, në ngarkim të H. P. Dosja ka 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
8. Dosje nr. 4573, në ngarkim të H. H. Dosja ka 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
9. Dosje Agjenturale “Merimanga” (problem i centralizuar), me 3 vëllime nr. 360, 363/1 dhe 363/2, në funksion të kërkesës mbi shtetasin S. H. Dosja ka në total 900 (nëntëqind) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
10. Dosar me tre vëllime mbi demonstratat në Kosovë. “Të dhëna nga burimet tona”. Dosari ka në total 687 (gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
11. Dosje me dy volume mbi “Goditjet në Kosovë” gjatë dhe pas demonstratave të mars-prillit 1981. Dosja ka në total 531 (pesëqind e tridhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
12. Dosje formulare nr. 2457, kategoria 2/B, në ngarkim të F. Th. Q., me 117 (njëqind e shtatëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
13. Dosje përpunimi nr. 1666, kategoria 2/A, në ngarkim të H. S. S., me 157 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
14. Dosje formulare nr. 4370, kategoria 2/A, në ngarkim të Z. M. D., me 350 (treqind e pesëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
15. Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, regjistër i të dëbuarve dhe internuarve, nr. 22, me 50 (pesëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “sekret”.
16. Dega e Punëve të Brendshme Berat, regjistër i të dëbuarve dhe internuarve, nr. 23, me 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “sekret”.
17. Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, regjistër i të dëbuarve dhe internuarve, dy volume, nr. 43 me 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë dhe nr. 44, me 100 (njëqind) fletë. Niveli i klasifikimit është “sekret”.
18. Dega e Punëve të Brendshme Elbasan, regjistër i të dëbuarve dhe internuarve, nr. 45 me 48 (dyzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “sekret”.
19. Dega e Punëve të Brendshme Tepelenë, regjistër i të dëbuarve dhe internuarve, 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “sekret”.
20. Dega e Punëve të Brendshme Gjirokastër, regjistër i të dëbuarve dhe internuarve, nr. 10, me 199 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit është “sekret”.

## **KRYETARE E KDZH-së**

**Gentiana Sula**

## **Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 10, datë 10.05.2019**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika “b” dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a, c, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 10, datë 10.05.2019, si më poshtë:

### **Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

1. Dosje formulare nr. 2552/3, kategoria 2/A, në ngarkim të Z. Gj. O. me 302 (treqind e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
2. Dosje drejtimi nr. 118 për ish-Klerin Reaksionar, me dy volume në total, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “sekret”.
3. Fashikull për zbulimin e veprimtarisë armiqësore të ish-Klerit Reaksionar nr. 300. Dosja përbëhet nga tri volume me 139 (njëqind e tridhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
4. Program mësimor i kursit njëvjeçar të Z., me 51 (pesëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
5. Dosje përpunimi nr. 12 519 dhe fashikull personal për të dënuar nr. 303-325/1, kategoria 2/B, në ngarkim të R. S. V. me respektivisht 105 (njëqind e pesë) fletë dhe 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
6. Dosje formulare–hetimore nr. 14 457, në ngarkim të A. S., me dy volume, në total 815 (tetëqind e pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
7. Fashikull për të arratisur nr. 2960/17, në ngarkim të I. L., me 61 (gjashtëdhjetë e një) fletë, 12 (dymbëdhjetë) fotografi në zarf dhe 60 letra korrespondencë në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
8. Fashikull për të arratisur nr. 2877, në ngarkim të A. F. B., me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
9. Fashikull nr. 452, në ngarkim të S. B. A., me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
10. Fashikull nr. 60, në ngarkim të N. Gj. M. (Gj.), me 152 (njëqind e pesëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
11. Fashikull nr. 2351, në ngarkim të B. M. D. me 44 (dyzet e katër) fletë dhe 20 (njëzet) fletë në zarf. Dosja i përket Fondit të të Arratisurit.
12. Fashikull personal për të dënuar nr. 301-303, në ngarkim të E. D. J., me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja i përket Degës së Punëve të Brendshme Shkodër.
13. Dosje formulare nr. 926, kategoria 2/B, në ngarkim të Q. R. O. me 45 (dyzet e pesë) fletë. Dosja i përket Degës së Punëve të Brendshme Kukës.
14. Dosje kërkimi nr. 771/4, në ngarkim të Y. S. M. me 33 (tridhjetë e tre) fletë dhe 2 (dy) fletë në zarf. Dosja i përket Fondit të të Arratisurit.

### **KRYETARE E KDZH-së**

**Gentiana Sula**

# VEPRIMTARI TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT MAJ - QERSHOR

## Vizitë e Komisionit të Ligjeve në mjediset e AIDSSH-së

**Tiranë, 7 maj 2019** - Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kontrollit parlamentar, zhvilloi një vizitë informuese në mjediset e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Vizita u krye në mjediset ku aktualisht ruhet arkivi i institucionit, në SHISH dhe IPQP, si dhe në ndërtesën e re të Autoritetit, pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

Deputetët pjesëmarrës në vizitë, z. Ulsi Manja, znj. Klotilda Bushka, znj. Vasilika Hysi, z. Fatmir Xhafaj, z. Bashkim Fino, z. Adnor Shameti, z. Alket Hyseni, z. Elena Xhina, z. Jurgis Çyrbja, z. Spartak Braho, z. Damian Gjikhuri, z. Edmond Leka, z. Tom Doshi, znj. Aurora Mara, z. Alban Zeneli, z. Adriatik Alimadhi dhe z. Korab Lita u pritën nga kryetarja dhe anëtarët e Autoritetit. Stafi i Sekretariatit Teknik demonstroi proceset komplekse të punës.

Deputetët e Komisionit të Ligjeve u njohën nga afër me gjendjen aktuale të arkivit të AIDSSH-së, vendruajtjet e dokumenteve arkivore dhe procedurat e arkivimit, administrimit, kërkimit, përdorimit dhe informimit të dokumenteve të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit.

Vizita në arkivin e AIDSSH-së në mjediset e SHISH-it, ku ruhet një pjesë e dokumenteve të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, të tërhequra nga Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme në vitin 1991, u ndoq nga vizita në arkivin e AIDSSH-së që ndodhet në ambientet e IPQP, ku ruhet një pjesë e dokumenteve të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, të tërhequra nga Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme sipas përcaktimeve të ligjit 45/2015.

Pas njohjes me të dy vendruajtjet arkivore të institucionit, grupi përfaqësues i Komisionit të Ligjeve vizitoi godinën e re të AIDSSH-së, e cila ndodhet brenda territorit të Ministrisë së Mbrojtjes. Hyrja në arkivat e AIDSSH-së në SHISH dhe IPQP u realizua në kushte të larta sigurie.





**Konferenca ndërkombëtare shkencore: "Fytyra e "Armikut të Popullit" gjatë diktaturës së proletaritetit në Shqipëri, 1944-1990"**

**Tiranë, 17 maj 2019** – Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Institutin e Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe Institutin për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë organizoi konferencën ndërkombëtare shkencore me temë: "Fytyra e "Armikut të Popullit" gjatë diktaturës së proletaritetit në Shqipëri, 1944-1990". Konferenca u zhvillua përgjatë gjithë ditës në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar, e hapur për mediat.

Gjatë ceremonisë së hapjes u mbajtën fjalët e organizatorëve dhe përfaqësuesve të trupit diplomatik, në praninë e studiuesve, kërkuesve shkencorë, përfaqësuesve të shoqatave të të drejtave të njeriut, të universiteteve të vendit dhe studentëve, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve publike e joqeveritare.

Në fjalën e saj, kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula, e vuri theksin te rëndësia e trajtimit të një subjekti të tillë në Shqipërinë postkomuniste, e cila ka nevojë ta rishikojë narrativën e regjimit dhe t'i rivlerësojë viktimat, ende të përndjekura nga stigma.

Bashkorganizatorë të konferencës mbajtën fjalën e tyre, z. Marenglen Verli, rektor i Akademisë së Studimeve Albanologjike, z. Agron Tufa, drejtor i Institutit për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe z. Bilal Kola, drejtor i Institutit për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë, duke paraqitur këndvështrimet përkatëse ndaj temës, trajtimit të saj dhe nevojës së shoqërisë shqiptare për njohje e studim të thelluar të së shkuarës.

Konferenca u përshëndet nga znj. Elva Margariti, ministre e Kulturës dhe zv.ministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi.

Përfaqësitë diplomatike në Tiranë, të pranishme në ceremoni, dhanë mbështetjen e tyre për këtë nismë, duke paraqitur propozimet përkatëse sa i takon trajtimit të drejtësisë tranzicionale

në vend. Z. Bernd Borchardt, Prezenca e OSBE-së, z. Johann Sattler, ambasador i Republikës së Austrisë, z. Alberto Cutillo, ambasador i Republikës Italiane, z. Karol Bachura, ambasador i Republikës Polake dhe znj. Monika Bylaite, Delegacioni European në Shqipëri, paraqitën qëndrimet e tyre ndaj rëndësisë së një konference të tillë në Shqipërinë postkomuniste.

Z. Borchardt e vuri theksin te mospërsëritja e së shkuarës, z. Sattler ngriti zërin për ruajtjen e vendeve përkujtimore si burgu i Spaçit, z. Alberto Cutillo solli përvojën e dhimbshme të kërkimit të të atit të Aldo Terruzit, Giuseppe Terruzi; z. Karol Bachura bëri thirrje për ngritjen e një memoriali në përkujtim të rezistencës dhe viktimave të komunizmit; znj. Monika Bylaite, përmes fjalëve të atë Zef Pllumit ftoi për reflektim përballë krimeve të së shkuarës. Përfaqësuesit diplomatikë e mbështetën nismën e trajtimit të të ashtuquajturve “armiq”, po ashtu vijimësinë e konferencës me profile të tjera.

Prof. Asoc. Dr. Sonila Boçi prezantoi punimin e saj “Disidentë pa disidencë: përsiatje mbi veçoritë e totalitarizmit në Shqipëri”, i pari i një dite të pasur, ku studiues shqiptarë e të huaj, kërkues shkencorë, historianë, aktivistë të të drejtave të njeriut dhe gazetarë diskutuan tematikën e zgjeruar të armikut të popullit në Shqipëri.

Në vijim, në sesione paralele në Muzeun Historik Kombëtar, “armiku i popullit” u trajtua nga pikëpamja filozofike, historike, politike, shoqërore, kulturore... Diskutimi teorik mbi konceptet “disidencë”, “disident”, “kundërshtar politik” u pasua nga lufta e klasave, tipologjia e njeriut të ri gjatë socializmit, sjellja e regjimit ndaj klerit katolik shqiptar, klerit ortodoks në Shqipëri, “armiku i djeshëm”, “kundërshtari i sotëm”; ngjashmëritë dhe dallimet në vizatimin e “armikut të popullit”; imperializmi amerikan-armik i përhershëm i regjimit komunist në Shqipëri; projektimi i “armikut të popullit” dhe ideologjia e tjetërsimit të individit; metamorfoza e “armikut të klasës” në radhët e Ushtrisë Popullore, nga “oficeri i deklasuar”, tek “oficeri puçist dhe oficeri poliagjent”; koncepti i “armikut” në aktet politike në fundin e vitit 1990 dhe fillimet e vitit 1991; imazhe, armiq dhe vese në shoqërinë komuniste; tipologjia e “armikut të popullit” në art, në romanet e novelat me agjenturë të realizmit socialist; kleri si “armik i popullit” në letërsinë shqipe; përjashtimi nga historia e letërsisë, si dënim për shkrimtarët “armiq”; fati i revistave kulturore “reaktionare” pas vendosjes së diktaturës; disidencja shqiptare midis mitit dhe realitetit; “çamët e pabesë” si kundërshtarë politikë të regjimit komunist e punime të tjera, me emra e profile konkrete “armiqsh të popullit”.

Në mbyllje, moderatorët, bashkë me studiuesit dhe të pranishmit e interesuar u mblodhën për konkluzionet e konferencës, mbi tematikën e diskutuar.

Puna për konferencën ka nisur prej muajsh dhe thirrjes për të marrë pjesë i janë përgjigjur me dhjetëra studiues shqiptarë e të huaj. Komisioni i vlerësimit përzgjedhi një pjesë të punimeve, duke i organizuar në panele të kërkimit shkencor dhe të kujtesës. Gjatë kësaj kohe, studiuesit kanë pasur mundësi të shfrytëzojnë inventarët, dosjet, statistikat dhe materialet e ndryshme arkivore të vëna në dispozicion nga AIDSSH apo të tjerë arkiva e, nëpërmjet kërkimit e objektivitetit shkencor, të mundësojnë një panoramë të zgjeruar të profileve të armiqve gjatë diktaturës, në aspektin historik, juridik, politik, filozofik, social e kulturor.



— PROGRAM —

Konferenca Ndërkombëtare Shkencore

## FYTYRA E 'ARMIKUT TË POPULLIT' GJATË DIKTATURËS SË PROLETARIATIT NË SHQIPËRI 1944-1990

Organizuar nga:  
Autoriteti për Informimin mbi Dosjet  
e ish-Sigurimit të Shtetit,  
në bashkëpunim me

Institutin e Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike,  
Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunitzmit  
Institutin e Integritit të Ish-të Përndjekurve Politikë dhe  
Muzeun Historik Kombëtar


**17 Maj 2019**

Muzeu Historik Kombëtar















### **Vizitë e delegacionit të Fondacionit Federal për Studimin e Diktaturës Komuniste në ish-Gjermaninë Lindore në mjediset e AIDSSH-së**

**Tiranë, 22 maj 2019** – Në kuadër të Ditëve të Qëndresës, një delegacion i Fondacionit Federal për Studimin e Diktaturës Komuniste në ish-Gjermaninë Lindore vizitoi Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për t’u njohur me punën, misionin e objektivat e tij, me qëllim ndërtimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet gjermane të kujtesës.

Delegacioni i përbërë nga 22 përfaqësues të lartë të institucioneve gjermane të memories, politikës, kërkimit shkencor dhe gazetarisë kryesohej nga Dr. Anna Kaminski, drejtore ekzekutive e Fondacionit. Kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula dhe anëtarët, z. Simon Mirakaj, z. Marenglen Kasmi dhe z. Altin Hoxha, i njohën të ftuarit me punën e institucionit për hapjen e dosjeve, transparencën në komunikimin me publikun dhe aktivitetet e shumta në funksion të përballjes me të shkuarën. Znj. Ardiana Topi, drejtore e arkivit të AIDSSH-së dhe z. Ermal Kaçkini i sektorit të kërkesave individuale, prezantuan punën e arkivit dhe drejtorisë së informacionit për vënien në dispozicion të dokumenteve dhe i njohën të pranishmit me sfidat me të cilat përballen në punën e përditshme.

Vizitorët, - secili me përvojë të pasur në fushën e arkivave, të kujtesës, gazetarisë investigative, politikës dhe përballjes ligjore me të shkuarën, - paraqitën interes konkret për punën e Autoritetit dhe shtruan shumë pyetje për diskutim, për njohje të thelluar të veprimtarisë së tij, përtej sfidave, të elementëve ende të patrajtuar të drejtësisë tranzicionale, si dhe ofruan ndihmë për projekte të përbashkëta.

Tema të ndryshme, që nga krijimi i institucionit për hapjen e dosjeve, pas miratimit të ligjit 45/2015, të vonuar me dekada për hapjen e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit;



perceptimi i AIDSSH-së në publik, përjetimi i persekutimit në kategori të ndryshme shoqërore dhe trajtimi i thelluar e profesional i së shkuarës; ngjashmëritë e ligjit shqiptar, i ndërtuar sipas modelit gjerman; apo kërkesat e shoqërisë civile e më gjerë për ligj më të ashpër, me përfshirjen e lustracionit, u diskutuan gjerësisht në takim, ku u përballën mendime dhe u shkëmbyen përvoja.

Kryetarja Sula bëri një paraqitje të punës së Autoritetit dhe nismave të ndërmarra prej tij, që nga ekspozitat dokumentare në qytete të vendit, sipas specifikës së komunitetit dhe ngjarjeve konkrete, te projektet komplekse të dëshmime gojore, publikimet cilësore dhe profesionale, të gjitha online në faqet e Autoritetit, bashkëpunimet me grupe të ndryshme shoqërore dhe artistë, universitete, kërkues shkencorë dhe të rinj. Autoriteti sapo përmbylli konferencën e dytë ndërkombëtare shkencore, e cila synon të vijojë me punë të thelluar kërkimore e kontekstualizim të fakteve historike.

Në mbyllje të takimit, përfaqësuesit e delegacionit gjerman përgëzuan AIDSSH-në për punën, këmbënguljen në zbardhjen e së shkuarës dhe transparencën në ushtrimin e detyrës, në një kohë kur janë të qarta vështirësitë e punës së një institucioni të tillë.





### **Ekspozitë dokumentare “Disidenca fetare në Shqipëri gjatë viteve 1967-1990”**

**Tiranë, 30 maj 2019** – Në kuadër të bashkëpunimit me universitetet, AIDSSH prezantoi ekspozitën me dokumente arkivore të përndjekjes së klerit katolik, ortodoks, mysliman dhe bektashi, në mjediset e Universitetit Europian të Tiranës, me praninë e përfaqësuesve të të gjitha komuniteteve fetare, mes të cilëve edhe të dënuar politikë nga regjimi komunist.

Takimi "Disidenca fetare në Shqipëri gjatë viteve 1967-1990", i zhvilluar nga UET, u hap nga znj. Nevila Nika, rektore e universitetit, bashkëpunëtoare e hershme e aktiviteteve të Autoritetit.

Znj. Ardiana Topi, Drejtore e Arkivit të AIDSSH u shpreh mbi rëndësinë e njohjes së dokumenteve të tilla të përndjekjes, për të dhënë përmasën e panjohur të historisë që ruhet në arkiva e që tashmë u vihen në dispozicion qytetarëve.

Bashkëpunimi mes akademikëve, studentëve dhe institucioneve të kujtesës kolektive u trajtua nga z. Konstantinos Giakoumis, Profesor i Asociuar i Universitetit Europian të Tiranës.

Në emër të komuniteteve fetare të pranishme, e mori fjalën z. Haxhi Dede Edmond Brahimaj, Kryegjyshi i Kryegjyshit të Botërore të Bektashinjve, me të cilët AIDSSH ka bashkëpunuar në vijimësi, në kuadër të punës për hapjen e dosjeve të klerikëve të përndjekur.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ekspozoi dosje të klerikëve të përndjekur, mes të cilave: dosje formulare nr. 1864 e Hafiz Ali Krajës; dosje formulare nr. 5 e Atë Gjergj Sulit; dosje formulare nr. 4783/A e Theofan Popës; dosje formulare nr. 5130/A e Baba Muharrem Sinanit; dosje gjyqësore nr. 1513 e Visarion Xhuvanit; dosje formulare nr. 304 e shtetasit Padër Mark Arapi; dosje gjyqësore nr. 4180 e Irene Banushit, etj.

Takimi u mbyll me premtimin e zgjerimit të aktiviteteve të tilla.









AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

---

Adresa  
Garda e Republikës, Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë  
[www.autoritetidosjeve.gov.al](http://www.autoritetidosjeve.gov.al)